FATMIR AGALLIU

PJESORJA NË GJUHËN SHQIPE

(analizë e kategorive dhe e funksioneve të saj)

Pjesorja e gjuhës shqipe mbetet një ndër çështjet ende të pastudjuara mirë, sidomos në pikëpamje të kategorive dhe të funksioneve të saj. Kjo na shtyn të bëjmë në këtë artikull një përpjekje për të rrokur në mënyrë sa më të plotë këto aspekte të pjesores së shqipes.

Para se të parashtrojmë përfundimet tona, e quajmë të nevojshme të japim një pasqyrë të shkurtër të trajtimit të kësaj kategorie nëpër gramatikat kryesore të gjuhës shqipe dhe në ndonjë punim të veçantë.

Sami Frashëri (Shkronjëtore e gjuhësë shqip, Bukuresht, 1886) si pjesore pranon vetëm trajtën me nyje: *i ardhur, e vajtur,* të cilën e quan *përgjysmore.* Këto trajta i shënon edhe në paradigmat përkatëse (f. 59 e vijim), ku figurojnë edhe të atilla, që nuk ekzistojnë në gjuhë si *i qenë, e qenë.* Më tutje (f. 70) thotë se pjesorja ka vetëm një kohë, sepse s'është folje, po një mbiemër i ardhur prej foljes, prandaj edhe «zihetë» një farë fjale me vetëhe». Siç shihet, Samiu pjesoren e ndan prej foljes dhe e merr si pjesë më vete të ligjeratës, duke e identifikuar morfologjikisht me mbiemrin (nëpër paradigmat shënon format e ndryshimit sipas gjinisë dhe numrit). Atë që shumica e gramatikanëve të shqipes e quajnë pjesore: *ardhur, vajtur,* Samiu, përkundrazi, e quan paskajore.

Anton M.Xanoni (Gramatika shqyp, 1909) mban termin e Samiut për pjesoren (përgjysmuer), por, ndryshe prej tij, pranon natyrën e dyfishtë të saj, atë foljore dhe mbiemërore: «Participi n'njen an' asht verb e m'njen'an' adiektiv, e prandej mundet m'u thanë përgjysmuer». (f. 91). Në paradigmat shënon dy kohë të pjesores: të tashmen (*kenës, pasës*) dhe të shkuarën (*kenun, pasun*) për foljet veprore, vetëm të shkuarën (*da, daam, daamun, lutë, lutun*) për foljet pësore. Atë që Gustav Meyeri (Kurzgefasste albanesische Grammatik, 1888, f. 43) vetëm e supozonte si një pjesore të vjetër të së tashmes, prej së cilës kanë dalë emrat e vepruesit ose të veglave: *hapës, mbytës* etj., Xanoni, përkundrazi e mori si një fakt ekzistues të shqipes së sotme.

Ilia Dilo Sheperi (Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe, 1927) flet për një mënyrë të pakufishme, duke nënkuptuar me këtë të gjitha format e pashtjella të shqipes, e cila, sipas tij, quhet pjesore, kur përdoret më vete: *punuar* ose *punue,* paskajare kur përdoret me parafjalën «me»: *me punue* dhe përcjellore, kur përdoret me fjalëzën duke (tue): *duke punuar* ose *tue punue* (f. 70). Ndërsa jep pak a shumë me hollësi formimin e pjesores me anë sufiksesh, për përdorimet nuk thotë asgjë, vetëm për-

mend kalimthi trajtat me nyje, të cilat i quan pjesore mbiemra. Nga sa duket, Sheperi anonte nga trajtimi i këtyre fjalëve si mbiemra.

A.Xhuvani (Libri i gjuhës shqipe, pjesa e dytë, për klasat e nalta të fillores e të parat e qytetses, 1939) nepër paradigmat shënon dy kohë të pjesores, të tashmen: *kërkue* a *kërkuar* dhe të shkuarën: *pasë kërkue*, pa thënë më parë asgjë se ç'është pjesorja. Trajtat *kërkue* a *kërkuar* nuk mund të mbahen kurrsesi si pjesore të tashme, ndërsa trajta *pasë kërkue*, që është nxjerrë nga paradigma *ka (kishte) pasë kërkue*, në fakt është e paqenë, sepse trajtat e mbipërbëra të tipit *ka (kishte) pasë kërkue* kanë rrjedhur nga të përbërat korresponduese të foljes ndihmëse, që i janë paravënë pjesores: *ka (kishte) pasë — kërkue*.

Është për t'u shënuar se një trajtim i tillë, prej të cilit Xhuvani më vonë do të heqë dorë (Pjesorja në shqipet, Buletin për shkencat shoqërore, 1954, 2), përsëritet edhe në disa gramatika të tjera shkollore, duke nisur me atë të O.Myderrizit (Gramatika e Re e Shqipes, 1944). Në këtë gramatikë pohohet se pjesorja rri ose si fjalë më vete, ose duke u bashkuar me foljet ndihmëse, por nuk jepet asnjë shembull për përdorimin e mvetësishëm të pjesores. Për kohën e shkuar thotë se përdoret më vete si mohore, duke marrë ndajfoljen *pa*; *pa pasë shkue* etj. Në të vërtetë, forma *pa pasë shkue*, ka dalë nga paravënja e formës mohore të foljes ndihmëse pjesores së foljes që tregon veprimin dhe, si të gjitha format e pashtjella të përbëra *(duke pasë dalë, me pasë dalë)* ka një përdorim të rrallë. O.Myderrizi, si edhe disa të tjerë gramatikanë pas tij, formën e tipit *pa ardhur* e quan pjesore në trajtë mohore. Ne nuk do të merremi në këtë artikull me analizën e kësaj forme. Duke u paituar me trajtimin e saj si një formë e veçantë e pashtjellë me kuptim mohor në disa studime të reja (M.A.Gabinski, Voznjiknovenie infinitiva kak vtoriçnyj ballkanskij jazykovoj process; Sh.Demiraj, Folja, kapitull për tekstin e gramatikës të Universitetit, maket, III, 1972), mendojmë t'i kushtojmë një artikull të veçantë.

Nga gramatikanët shqiptarë K.Cipo është i pari që bën një parashtrim pak a shumë të gjerë të kësaj kategorie. Si përkufizimi, ashtu edhe njoftimet e tjera për gjendjen, kategoritë dhe përdorimet e pjesores janë të sakta. Me sa duket, K.Cipo nuk bën dallim midis pjesores së vërtetë dhe mbiemrit foljor (pjesores së nyjëzuar), sepse shembujt që jep për të provuar kuptimin vepror dhe pësor të pjesores, janë mbiemra të nyjshëm (njeri *i ditur*, burrë *i pasur*, o *i sjelli* mbi gomar etj.) dhe, nga ana tjetër, tek formimi i mbiemrave flet për mbiemra të ardhur nga mbiemra foljorë: *i ngordhur, ngordhaq*, por vetë mbiemrat foljor nuk i përmend në këtë temë.

A.Xhuvani, si u tha, i ka kushtuar pjesores një studim të plotë. Ndryshe nga disa autorë të tjerë, në pikëpamje të kategorizmit gramatikor ai vë një kufi të prerë, sipas nesh me të drejtë[1], midis pjesores dhe mbiemrit foljor, por, në pikëpamje të kuptimit, një ndarje kaq e prerë nuk na duket bindëse: «në gjuhët tanë pjesorja ban pjesë gjithmonë në natyrë të foljes dhe vetëm kur kthehet e bahet mbiemën, mbiemën participor, tregon një cilësi . . .» (Studime gjuhësore, f. 200). Siç do të vëmë në dukje edhe më poshtë, pjesorja me të vërtetë është folje dhe tregon një veprim, por këtë e paraqet si një tipar, cilësi të sendit, dhe në këtë pikë afron kuptimisht

1) Në një artikull tonin (Mbi pjesët e ligjëratës në gjuhën shqipe, Studime filologjike, 4. 1970) kemi dhënë edhe argumentat në të mirë të trajtimit të pjesores së paranyjëzuar si mbiemër

me mbiemrin. Në punimin e Xhuvanit për herë të parë analizohen funksionet sintaksore të pjesores së mirëfilltë.

Sh. Demiraj në tekstin universitar «Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe, II, 1963», ndërsa përshkruan me hollësi format e pjesores, jep shkurt edhe disa nga përdorimet kryesore të saj, duke u shtuar atyre që shënon Xhuvani, edhe përdorimin si kallëzues i një fjalie të pavarur, zakonisht si pjesë e cunguar e një kohe të kryer të foljes.

*
* *

Siç dihet, nga gjithë trajtat e pjesores, që ekzistojnë në gjuhë të ndryshme indoevropiane, në gjuhën shqipe ruhet vetëm një trajtë. Ajo nuk ka asnjë nga kategoritë gramatikore [1], që karakterizojnë pjesoren si një trajtë foljore me veti të foljes dhe të mbiemrit (diatezë, kohë, gjini dhe numër). Për kategori gramatikore zakonisht bëhet fjalë vetëm atëhere kur kuptimeve gramatikore të fjalëve u përgjigjen edhe forma gramatikore të ndryshme. Nga kjo pikëpamje pjesorja e shqipes paraqitet e pandryshueshme. Megjithatë ajo duhet trajtuar si pjesore, përfshirë në sistemin foljor, për këto arësye:

1) Sikurse format e shtjella, pjesorja shpreh një veprim, por ndryshe prej tyre, e paraqet atë jo si proces, por si tipar;

2) Si në gjuhë të tjera, ashtu edhe në shqipen me ndihmën e saj formohen trajtat kohore analitike;

3) Karakterizohet nga reksioni foljor, d.m.th. mund të marrë një plotës vepruesi ose plotësa rrethanorë.

4) Ka kuptimin e kohës së shkuar dhe atë të diatezës pësore kur vjen prej një foljeje kalimtare.

Kur përdoret me vlerën e një gjymtyre të fjalisë, pjesorja paraqitet gati si sinonimike me mbiemrin. Pikërisht funksioneve të pjesores si një gjymtyrë e fjalisë u kushtohet kryesisht ky artikull. Këtu po shënojmë në mënyrë paraprake se në këto funksione në shqipen e sotme letrare pjesorja ka një frekuencë përdorimi të kufizuar. Kjo besoj se duhet shpjeguar me paaftësinë e pjesores për të dalluar gjininë dhe numrin e emrit, të cilit i atashohet, domethënë me mungesën e këtyre kategorive. Në këtë pikë pjesorja dallohet nga mbiemri i nyjshëm, nyja e përparme e të cilit është treguesi kryesor i jashtëm (si të thuash, analitik) i kategorive të numrit, gjinisë dhe rasës. Me ngulitjen me kalimin e kohës të nyjes para mbiemrit[2], ky i fundit u dallua formalisht nga pjesorja, sepse, ndryshe prej saj, ka forma të përshtatjes së plotë në gjini, numër dhe rasë. Kjo bëri të mundur që edhe pjesorja, në të njëjtat funksione me ato të mbiemrit, të paranyjëzohet, duke marrë kështu formën e mbiemrit, megjithëse mund të ruajë kuptimin kategorik të veprimit dhe tiparet e reksionit foljor (aftësinë për të marrë plotës kohe, vendi si dhe plotës të vepruesit). Siç jemi shpjeguar më hollësisht

---

1) Këtë ide e ka formuluar dhe zhvilluar kohët e fundit Sh. Demiraj në kapitullin e foljes për gramatikën e re të Universitetit (Gramatika e gjuhës së sotme shqipe, Morfologjia (maket) III, 1972.)

2) Për moshën relativisht të vonë të nyjes së përparme shih E. Çabej, *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe»*, BUSHT, SSHSH, 3, 1963, f. 79 e vijim.

në një rast tjetër [3], për arësye të formës mbiemërore dhe të kategorive tipike për mbiemrin, si edhe për funksionin e tyre, këto përdorime do të trajtohen prej nesh si mbiemra dhe jo si pjesore, ashtu siç mendonte S. Frashëri.

Hetimi i historisë së brendshme të këtij fenomeni, domethënë shtimi dhe zhvillimi i ndërtimeve me mbiemra foljorë dhe dobësimi i frekuencës së përdorimit të ndërtimeve me pjesore është një çështje interesante për t'u studjuar nga fusha ende e parrahur mirë e historisë së gjuhës shqipe të shkruar. Nga një ballafaqim i pjesshëm mund të hetohet se në veprat e atyre shkrimtarëve, që i qëndrojnë më afër gjuhës popullore, ndërtimet me pjesore janë më të shpeshta (A. Asllani, J. Xoxa, S. Andoni etj.), ndërsa në shkrimtarë të tjerë hasen më pak (N. Frashëri, Dh. Shuteriqi, F. Noli [4] etj.).

Në veprën «Bagëti e bujqësia» të N. Frashërit, për shembull pjesorja si gjymtyrë fjalie është përdorur gjithsejt dhjetë herë, duke futur këtu edhe ato me funksion kallëzuesor. Edhe në poezinë e L. Poradecit, po të gjykojmë vetëm në bazë të një vëllimi prej 61 faqesh, duke hequr parathënjen, dalin 12 raste pjesoreje, megjithëse padyshim ai është një ndër shkrimtarët, që e ka shfrytëzuar me mjeshtëri pasurinë e gurrës popullore.

Në poezinë me frymë, figura dhe gjuhë popullore të A. Asllanit pjesorja përdoret dendur dhe drejt. Përshembull, në këta nëntë vargje gjejmë nëntë trajta të pjesores:

Ai i kujtonet, *veshur* me fustane,
në një dor' tespihet vark e radh' merxhane,
dhe në dorën tjetër një çibuk sermaje,
rrahur me sadefe, gurë qehribaje.
Vula dhe sahati *varur* përmbi gryk'
dhe mbi supe *hedhur* atë goxha qyrk.
Dredhur dhe mustaqet, *dredhur* dhe *përdredhur*,
brenda në silahe dy pisqolla *kredhur*,
kredhur dy pisqolla dhe harbin' e artë, ... (V. P. 118)

Në veprat në prozë të J. Xoxes (Novela, Lumi i vdekur) pothuaj në çdo faqe gjen trajta të pjesores me vlerën e një gjymtyre të fjalisë. Te ky autor përdorimi i shpeshtë i ndërtimeve me pjesore ka fituar tiparet e një veçorie të stilit. Por, siç do ta shtjellojmë më pas, në disa raste ka edhe teprime, duke shkuar kundër natyrës së gjuhës. Këtë, me sa duket, e ka ndjerë edhe vetë autori, sepse në romanin e tij të ri dhe voluminoz «Juga e bardhë», pjesorja përdoret me masë dhe përgjithësisht drejt.

---

3) F. Agalliu, *Mbi pjesët e ligjeratës në gjuhën shqipe*, Studime filologjike, 4, 1970, f. 87-88.

4) Është interesante të vihet re se F. Noli, ndërsa në «Historinë e Skënderbeut» përdor pothuaj kudo ndërtimet me mbiemra foljorë, në poezitë ka disa ndërtime me pjesore, por kryesisht në funksion kallëzuesor dhe vetëm në dy raste në funksionin e përcaktorit jopredikativ: «O flamur gjak, o flamur shkabe, — O vend e vatr'o nën'e babë, — *larë* me gjak, *djegur* me flakë, — Flamur i kuq, flamur i zi. (Noli, Album, 29).

Prej kohësh është vënë në dukje se shqipja ka vetëm një trajtë pjesoreje, atë të kohës së shkuar. J. G. Hahn pohon se pjesorja në gjuhën shqipe kufizohet në «participin e së shkuarës» (das Particip der Vergangenheit) [5]. Këtij mendimi i përmbahet edhe Gustav Meyeri [6]. Kohët e fundit mendimin se pjesorja e shqipes është e kohës së shkuar e kanë përkrahur edhe A. V. Desnickaja dhe Sh. Demiraj [7]. Ky pohim, sipas mendimit tonë, në thelb mbetet i drejtë, edhe po të mos vërtetohet dot që shqipja ka pasur dikur një pjesore të kohës së tashme, domethënë ai ka vlerë si për vështrimin historik, ashtu edhe për atë aktual të çështjes. Por për këtë duhen bërë disa sqarime. Së pari, në pikëpamje të kohës pjesorja duhet dalluar nga paskajorja dhe përcjellorja. Paskajorja «rrëfen» thjesht një veprim si proces, jashtë kohës në të cilën ai mund të kryhet, ndërsa përcjellorja «rrëfen», një veprim, që shoqëron një veprim tjetër dhe kryhet në të njëjtën kohë me të, pra ajo ka një përdorim mbarëkohor, gjë që në planin e përmbajtjes përfaqëson një neutralizim të kuptimit kohor. Në planin e shprehjes kjo shfaqet në përdorimin e së njëjtës formë në shoqërim me folje të të tria kohëve. (Po vinte *duke kënduar*, po vjen *duke kënduar*, do të vijë *duke kënduar*).

Në shumicën e përdorimeve të saj me vlerën e një gjymtyre të fjalisë pjesorja e gjuhës shqipe tregon rezultatin e një veprimi të shkuar në një çast të caktuar të së tashmes, së shkuarës ose së ardhshmes: «Zonjatë bukuroshe, *veshur* rrobat e arta . . . , *vinë* rreth e kërcejnë». (Frashëri, Lulet, 64); «Këmbëza, *ndërtuar* mbi tri bregore, *duket* se ka qenë edhe në kohëra më të vjetra; . . . (Sako, Buka, 5); «S'e vë fshatin unë mbi kumbaren, se fshati s'më pyeti në *jemi* gjallë a *vdekur*». (Xoxa, Lumi, 1, 221); «Mua më *zuri* gjumi pranë zjarrit, me kokën *mbështetur* te një samar». (Shuteriqi, Gurnecka, 148); *Do ta sjellin lidhur*.

Prandaj, kur flasim për kuptimin kohor te pjesorja, duhet të kemi parasysh veprimin si të tillë, vendosjen e tij në kohë dhe jo pasojat e tij në një nga momentet e tri kohëve themelore të foljes (së shkuarës, së tashmes dhe së ardhmes). Nga kjo pikëpamje na duket i drejtë përcaktimi i pjesores së shkuar të frengjishtes, që jep Maurice Grevisse: «Pjesorja e shkuar shpreh një fakt të shkuar në lidhje me një fakt (të tashëm, të shkuar ose të ardhshëm), që tregon folja e fjalisë . . .» [8].

Së dyti, duhet bërë një dallim midis kohës si kategori gramatikore, që karakterizohet nga një sistem formash, që i kundërvihen njëra-tjetrës, dhe kuptimit kohor, i cili te pjesorja shfaqet në raport me foljen e fjalisë, domethënë në mënyrë relative, si një veprim i shkuar (paraardhës), që paraqitet në formë rezultati. Këtu duhen pasur parasysh përdorimet e pavarura të pjesores, sepse në kohët e përbëra ajo e humbet mvetësinë e saj, shënon vetëm veprimin, ndërsa kuptimin kohor dhe atë të diatezës, si edhe kuptimin rezultativ e përmban gjithë ndërtimi analitik, prandaj me të drejtë në këtë funksion ajo emërtohet nga disa gjuhëtarë pseudopjesore, për t'u dalluar nga pjesorja e mirëfilltë.

---

5) *Albanesische Studien*, Heft II, 1854, f. 42.

6) *Kurzgefasste albanesische Grammatik*, 1888, f. 42.

7) A. V. Desnickaja, *«Mbi strukturën morfologjike të gjuhës shqipe»*, (përkthyer dhe botuar në BUSHT, SSHSH, 3, 1959, 222). Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe* (dispensë), II, 1963, f. 240.

8) M. Grevisse, *Le bon usage*, Paris, 1964, f. 708.

Kohën si kategori gramatikore pjesorja e shqipes, natyrisht, nuk e ka, sepse mungon opozicioni formal, por kohën si kuptim gramatikor e ka, meqenëse ky kuptim është karakteristik për foljen si klasë fjalësh, brenda së cilës përfshihet edhe pjesorja. Por këtu duhet bërë një saktësim terminologjik. Në vend që të thuhet se shqipja ka vetëm një pjesore të së shkuarës ose siç thoshte G. Meyeri «Në përdorimin e gjallë si participium është vetëm një pjesore e preteritit pësor» [9], duhet thënë se gjuha shqipe ka vetëm një pjesore, e cila, siç e ka përcaktuar drejt Dozoni [10], ka kuptimin e së shkuarës (Le participe a le sens du passé, il est le même pour les deux voix).

Në disa raste, kur kemi të bëjmë me folje kursive (kuptimisht të aspektit të zgjatur, të tilla si foljet *shoqëroj, mbërthej, mbështes* etj.), pjesorja mund të tregojë edhe një veprim të njëkohshëm me atë të foljes së fjalisë. Kjo ndodh kryesisht në ndërtimet, ku pjesorja paraqitet si gjymtyrë e veçuar, kuptimisht afër fjalisë dhe ekuivalente me një kohë të shtjellur të foljes ose me përcjelloren: 1) Kur pushoi kënga, *shoqëruar* nga një klithmë e egër e djaloshit, rreth e rrotull sundoi përsëri qetësia» (Xoxa, Lumi, 1, 55) 2) «Pastaj, me radhë, dolën fustanelle të tjera, *mbërthyer* me jataganë . . .» (Shuteriqi, Gurnecka, 45) 3) «*Mbështetur* mbi maliher, ai u hoq duke çaluar . . .» (Buxheli, Kali, 164). Në përdorimet e tipit të shembullit 1 dhe 2 pjesorja paraqitet ekuivalente me të pakryerën pësore të dëftores (kur pushoi kënga, që *shoqërohej* nga një klithmë e egër e djaloshit), kurse në përdorimet e tipit të shembullit 3 ajo është ekuivalente me përcjelloren (*duke u mbështetur* mbi maliher, ai u hoq . . .).

Kuptimi i njëkohësisë, që mundësohet nga karakteri kursiv i veprimit të foljes prej nga formohet pjesorja, është i kushtëzuar nga funksioni në fjali, varet prej tij, po ashtu edhe nga konteksti. Nga ana tjetër, duhet pasur parasysh se përdorimi i pavarur i pjesores në shqipen e sotme letrare është kufizuar mjaft për shkak të zëvendësimit të saj nga pjesorja e adjektivuar. Veç kësaj, aspekti i foljeve si kategori semantike për gjuhën shqipe është fare pak i studjuar [11]. Mbas një studimi të hollësishëm të aspektit të foljes në këtë vështrim dhe mbas një studimi po ashtu të thelluar të mbiemrave foljorë, duke i diferencuar semantikisht në krahasim me pjesoren, mund të dalin në shesh fakte të reja, për ta parë çështjen e kohës te pjesorja me përdorim të mvetësishëm në një dritë të re. Tani për tani ne kemi bindjen se vlera kohore themelore është ajo e parakohësisë, ndërsa njëkohësia shfaqet vetëm në kontekste të caktuara. Madje edhe në folje terminative si folja *kap* në kontekste të caktuara mund të jepet ideja e një veprimi të njëkohshëm: «. . . *kapur* pas tokës, sikur tallej me veriun». (Andoni, I dërguar, 116).

Përsa i përket kategorisë gramatikore të diatezës, e cila në gjuhën shqipe dallohet qartë me anë të mjeteve morfologjike në çdo mënyrë e trajtë kohore, duhet thënë se edhe ajo i mungon pjesores. Nga pikëpamja thjesht formale, siç dihet, folja e shqipes ka dy diateza: veproren dhe pësore-vetvetoren. Aftësia për të ndryshuar sipas diatezës, nga ana

---

9) G. Meyer, *vepër e cituar*, f. 42.

10) Auguste Dozon, *Manuel de la langue chkipe au albanaise*, 1879, f. 225.

11) Për këtë problem deri më sot ka shkruar vetëm K. Cipo (Sintaksa, 1952, f. 49 e vijim).

tjetër, varet nga karakteri kalimtar apo moskalimtar i foljes, gjë që përcaktohet nga kuptimi i foljeve.

Te pjesorja mund të flitet vetëm për kuptime diatezore (veprore, pësore) dhe jo për diatezën si kategori gramatikore, sepse pjesorja s'ka forma ndryshimi për të shprehur këto kuptime. Kuptimet e diatezës së pjesores lidhen me kuptimin kalimtar ose moskalimtar të foljes, prej nga është formuar kjo apo ajo pjesore, prandaj pohimet e disa gjuhëtarëve si Majerit [12] dhe Xhuvanit[13] se pjesorja e shqipes është pësore (pasive) nuk janë plotësisht të sakta për gjendjen e sotme të gjuhës. Më drejtë do të ishte të thuhej, ashtu siç shprehet Dozoni [14], se shqipja ka një formë pjesoreje për të dy diatezat.

Pjesoret që vinë nga folje kalimtare, kanë kuptim pësor: «Varen xhake, tallagane, plaçka *tjerrur* nëpër stane! (Asllani, V. p. 76), «Çirrem, digjem i vrerosur, *sakatosur, çarmatosur*, . . .» (Noli, Album, 70). Kuptimi i diatezës pësore shprehet edhe sintaktikisht me praninë e plotësit të vepruesit: «E para . . . doli në hajat këtë të djelë plaka e Pilo Shpiragut, *ndjekur nga Vita* dhe *nga Kili.* (Xoxa, Lumi, 1, 101). « . . . kjo ishte rruga e famshme Egnatia, *ndërtuar* nga romakët dymijë vjet më parë . . . » (Shuteriqi, Gurnecka, 145). Me gjithë praninë e plotësit të vepruesit, i cili më shpesh haset në ndërtimet me pjesore dhe me mbiemra foljorë dhe më rrallë me forma të shtjelluara të foljes[15], nuk mund të flitet për diatezë pësore të pjesores në këto raste, sepse diateza është një kategori morfologjike dhe jo sintaksore, që shprehet me format e vetë foljes.

Në kohët e përbëra të diatezës pësore e vetvetore kuptimi diatezor përmbahet nga i gjithë ndërtimi analitik, në formimin e të cilit kuptimi pësor i pjesores duhet të ketë luajtur një rol me rëndësi.

Pjesoret e foljeve moskalimtare e mesore kanë kuptim vepror: «*Përhapurë* bagëtia nëpër sheshe, nëpër brinja . . . .» (Frashëri, Bagëti, 16); « . . . pranë tij, *mbështetur* mbi tryezë, flinte një njeri». (Arapi, Dhjetor, 107); « . . . duke parë nga djali . . . që e kishte habitur me atë gojën e tij brisk, *ardhur* kaq shpejt, pyeti . . .» (Xoxa, Lumi, 1, 197); « . . . qeramidhet *dalë* boje . . . dukeshin si copëra tullash . . . » (Andoni, I dërguar, 74).

Te mbiemrat foljorë kuptimi pësor del më i qartë, prandaj, meqenëse foljet kalimtare përbëjnë shumicën, është mirë që këta mbiemra të përdoren kryesisht për këto folje. Për foljet e diatezës mesore dhe për ato moskalimtare, të cilat nga kuptimi janë fort afër njëra-tjetrës, për mendimin tonë duhet parapëlqyer pjesorja, e paadjektivuar, e cila e vë në dukje më mirë kuptimin e veprimit, pa u ngarkuar edhe më shumë me kuptimin e diatezës, që në rastin e foljeve mesore mund të sjellë edhe paqartësi, sepse mesoret nga pësoret nuk dallohen formalisht. Të krahasojmë për këtë përdorimet e zakonshme: «. . . *ulur* në bisht, siç ishte, qeshte». (Arapi, Dhjetor, 117), «Razimi me të plotfuqishmin e grumbullimit akoma po rrinin në oborr, *ulur* mbi një krah dru». (Sako, Buka, 16), me këto përdorime më të rralla: «*E ulur* në buzë të sofrës, ajo përgjoi me orë të tëra. . . » (Abdihoxha, Vjeshtë, 71); « . . . plaka *e ulur* pranë tij

12) Gostav Meyer, vepër e cituar, f. 42.
13) A. Xhuvani, Studime gjuhësore, f. 201.
14) Auguste Dozon, vepër e cituar, f. 225.
15) Shih edhe K. Cipo, *Gramatika shqipe*, 1949, f. 109.

me duar të lidhura në prehër, ishte zhytur në mendime . . . » (Abdihoxha, Vjeshtë, 47).

Kështu, për foljet mesore *ngrihem, largohem, nisem, afrohem* duhen përdorur pjesoret *ngritur, larguar, nisur, afruar* dhe jo mbiemrat foljorë. Madje për ndonjë folje moskalimtare formimi i mbiemrit foljor paraqitet edhe i pamundshëm, si për shembull për foljen *rri:* «Qerrtari . . . dhe Kozma Ndreka, *ndenjur* që të dy mbi duajt e lëpushkës, . . . ia kishin marrë me nge». (Xoxa, Lumi, 1, 177). Mbiemri *i ndenjur* vështirë se mund të përdoret. Kuptimi kryesisht pësor i mbiemrave foljore bie ndesh me përmbajtjen veprore të pjesoreve të ardhura nga foljet moskalimtare dhe mesore dhe bëhet kështu një faktor pengues në shtrirjen gjithandej të ndërtimeve me mbiemra foljore në dëm të ndërtimeve me pjesore.

Pra, megjithë zgjerimin e përdorimit të mbiemrave foljorë në dëm të pjesores, ndërtimet me pjesore në disa raste dalin më të qarta, sepse mënjanojnë dykuptimshmërinë dhe ndonjëherë janë edhe të pazëvendësueshme.

* * *

Pjesorja e gjuhës shqipe njeh disa funksione. Ajo mund të jetë në fjali:

I) Përcaktor i një emri, në rolin e epitetit, si një gjymtyrë që përcakton drejtpërdrejt emrin. Si e tillë ajo vjen menjëherë pas tij e nuk ndahet me presë në të shkruar, domethënë nuk veçohet me pauzë. Në këtë funksion pjesorja shoqërohet pothuaj gjithmonë nga një gjymtyrë tjetër përcaktuese me raporte objektore, rrethanore etj., për shembull: «gjith' natën e natës / rri e flas me yje, / degat e lojthatës / *varur* përmbi krye» (Frashëri, Lulet, 64); «Çobani njohu fytyrën e beut çapëlyer nga pija». (Xoxa, Novela, 18); «Eci përmes kopshtit *rrethuar* me mure të larta, . . .» (Abdihoxha, Ngjyra, 18).

Edhe në prozën popullore ndërtime të tilla janë të zakonshme: «I thotë nafti që atë njeri e gjemë më një nisi të shkret, edhe ka një kaikë *ngarkuar* me krip . . . (Mbledhës, f. 370).

Fakti që pjesorja në funksionin e përcaktorit epitet të një emri shoqërohet nga fjalë të tjera përcaktuese, duhet shpjeguar me këtë që krahas saj përdoret edhe mbiemri prejpjesor, i cili, veç formës, ka fituar në një shkallë të madhe ose të vogël, edhe sementikën mbiemërore, rrjedhimisht edhe mundësitë sintaksore për t'u përdorur në funksionet e mbiemrit pa kufizime strukturore si të gjithë mbiemrat e tjerë. Kjo ka sjellë që ndryshimi formalo-kuptimor midis pjesores dhe mbiemrit prejpjesor të pasohet edhe nga një ndryshim strukturor në fjali, sepse, përndryshe, një përputhje funksionale me një shtrirje kaq të gjerë pa asnjë tipar tjetër dallues do të ishte një gjë e padurueshme për gjuhën, ku dallimet lozin një rol të madh. Është pikërisht gjymtyra përcaktuese, që ndjek pjesoren, ajo që thekson karakterin foljor të saj. Mjafton të krahasojmë: «Balli *mbushur* plot me rrudha, gjurm' e moshës, gjurm' e shkretë, . . .» (Asllani, V.p. 33) me «Ballë i *mbushur*, fytyrë e *hequr* etj.». Por, siç u tha, në shumicën e rasteve pjesorja mund të përdoret si e tillë edhe duke qenë e nyjëzuar (Balli *i mbushur* plot me rrudha . . .). Në këtë pikë autorët dallohen prej njëri-tjetrit. Disa edhe e teprojnë, duke nyjëzuar pjesoret e

foljeve moskalimtare, si përshembull: «Në fillim iu bë në ëndërr një fëmijë e vogël *i hypur* majë fikut, . . .» (Buxheli, Kali, 73).

Kur përdoret si epitet, për shkak të kuptimit të saj foljor, pjesorja mund të zëvendësohet nga një fjali përcaktore lidhore, përshembull: «Në brazdat e ugareve *hapur* atë vjeshtë rosat e hanit po zgjonin me të goditura qokthi krimbat e kuq . . .» (Xoxa, Lumi, 1, 64) — në brazdat e ugareve *që ishin hapur atë vjeshtë* . . . etj.

II) Përcaktor i veçuar i kryefjalës ose i një gjymtyre tjetër të fjalisë, të shprehur me emër ose përemër:

«Sot Lumta kishte veshur një triko të kuqe, **punuar** këtu e tre vjet më parë». (Abdihoxha, Vjeshtë, 60); «Po them unë — dhe Bilush Rrumbullaku, **veshur** me një këmishë sikur ja kishin shqyer qentë, u ngrit në këmbë». (Sako, Buka, 35); «Njerëzit, **mbledhur** shpejt në kasollet e *shtruar* anë vatre, thoshin...» (Xoxa, Lumi, 1, 194).

Si përcaktori epitet i shprehur me pjesore, ashtu edhe përcaktori i veçuar, del kryesisht si gjymtyrë e zgjeruar. Në rastet kur bashkërenditen dy pjesore, mund të mos ketë zgjerim: «Po sot, **tharë** e **zbardhur**, dukej si një kokër vezë». (Xoxa, Juga, 1, 40).

Si u tha më sipër, edhe në rolin e përcaktorit të veçuar, më shpesh në letërsi përdoret pjesorja e adjektivuar: «Blerta, e *mbështetur* mbi një deng bari, kishte vënë duart nën kokë . . .» (Abdihoxha, Ngjyra, 1, 13); Kalorësia turke, e *penguar* në çdo hap nga lisat dhe nga dushqet, e *ndjekur* dhe e *pritur* nga çdo anë prej shqiptarëve, . . . u shkatërrua . . . (Noli, Histori, 47- 48); «Ajo ishte një orkestër e re, *e krijuar* dy muaj më parë nga amatorët e kantierit. . .» (Kadare, Dasma, 14).

Ndodh që tek i njëjti autor, në të njëjtën frazë, na del edhe trajta e thjeshtë e pjesores, edhe pjesorja e adjektivuar: «Rruga e vjetër me emrin e çuditshëm Egnatia, *mbetur* që nga koha e romakëve, e *prishur* vendevende dhe e *rregulluar* me shpejtësi prej reparteve të xhenierëve . . . dukej sikur nuk do të mbaronte kurrë» (Kadare, Kështjella, 8).

Përcaktori i veçuar, sikurse përcaktori epitet, shpesh mund të zëvendësohet nga një fjali përcaktore lidhore; madje në rastet kur kemi të bëjmë me një pjesore me kuptim vepror ose moskalimtar, duhet parapëlqyer ndërtimi me fjali dhe jo pjesorja, e cila kryesisht ka kuptim pësor. Prandaj, sipas mendimit tonë, duhen mënjanuar përdorime të tilla të rralla: «. . . i kishte vdekur burri nga një plagë e vjetër, **marrë** në kohën e luftës, si ballist». (Sako, Buka, 129). «. . . zagarët ndërsyer e **marrë** zemër nga njëri-tjetri, s'pyesnin as për popla, as për dru . . .» (Xoxa, Lumi, 1, 176); «. . . kishte ndihmës sekretarin e komunes, zotin, Kristaq Milo, djalë me shkollë, **mbaruar** në Janinë e Athinë» (Andoni, I dërguar, 74); «Myzeqares, **humbur** në mes të avujve të bardhë, . . . iu duk drita e diellit si një tufë qirinjsh. . .» (Xoxa, Lumi, 1, 144).

III) Përcaktor predikativ i kryefjalës dhe i kundrinës:

«Si një yll që është këputur në një arqe brenda **futur**, sot arriti. . .» (Asllani, V.p. 58); «Ajo tërë jetën kish jetuar **zhveshur** e **zbathur**» (Buxheli, Kali, 279); «Ushtërinë pse e le **therur** fushës për vajtim?» (Noli, Album, 81); «Së shpejti ata do të rrinin **mbështetur** mbi shiltet e buta» (Kadare, Kështjella, 106).

Si përcaktor predikativ i kundrinës pjesorja shkon shumë rrallë edhe me foljen *kam:* «Gojën s'e kishe **zënë**, de, që të ma mbaje mbyllur». (Xoxa, Lumi, 1, 243). Opozicioni me pjesoren tjetër, *mbyllur*, vërteton se

këtu s'kemi një formë të më se të kryerës. Gjurma të një ndërtimi të tillë të dikurshëm, që, siç dihet, ka shërbyer si pikënisje për krijimin e formave perifrastike të perfektit, gjejmë edhe në prozën popullore: «edhe ajo kish katrë llambadha *dhezur*, kish edhe katrë *pa dhezur*, e ato, që kish *dhezur*, ishnë hazër me të sosur, . . .» (Mbledhës, 376).

Ndërsa me folje të tjera përdoren paralelisht në funksion predikativ edhe pjesorja edhe mbiemri foljor, shpeshherë për variacion stilistik, me foljen *kam* në këtë funksion përdoret rregullisht mbiemri foljor, përshembull: e kam *të ndrequr* shtëpinë. Kjo shpjegohet me gramatikalizimin fort të hershëm të konstruktit *kam ndrequr* dhe, rrjedhimisht, me prirjen e gjuhës për diferencim. Prandaj, të ashtuquajturat «forma të dyta» të perfektit, për të cilat flet K. Cipo [16], nuk shprehin medoemos veprim, siç vëren me të drejtë M. A. Gabinski [17], i cili, megjithatë lë të kuptohet se edhe në këto raste kemi të bëjmë me një zhvillim të dytë drejtë perfektit të përbërë si në gjuhët latino-romane dhe gjermanike, zhvillim që në shqipen ka nisur prej kohësh dhe në gjuhën e sotme përfaqëson një shfaqje të zakonshme[18]. Shëmbujt që ka sjellë, ndër të tjera: «*Garat i kemi të fituara*». (V. Sejko). «*Ç'është e drejta, të vjedhur e kam këtë fjalë* (S. Andoni), janë interpretuar drejt, por, sipas mendimit tonë, këto raste e mjaft të tjera si këto përfaqësojnë vetëm një prirje, megjithëse të vjetër, që s'ka për të çuar dot në krijimin «e formave të dyta të perfektit».

Një gjë e ngjashme me përdorimin e rrallë të pjesores si përcaktor predikativ i kundrinës me foljen *kam* vihet re edhe në përdorimin e saj si kallëzues emëror me foljen *jam*, por me një frekuencë më të madhe.

Interpretimi si kallëzues emëror s'lë shteg dyshimi, kur kemi të bëjmë me pjesore të foljeve moskalimtare, të cilat s'kanë diatezë pësore-vetvetore, rrjedhimisht as formë pësore të perfektit, të ndërtuara me ndihmësen *jam:* «Anëtarëve të komisionit, që ishin *ndenjur* para një tryeze të gjatë, u kishin vënë kapela kashte . . . (Andoni, I dërguar, 67); «s'e vë fshatin unë mbi kumbaren, se fshati s'pyet në jemi gjallë a *vdekur*» (Xoxa, Lumi, 1, 221); «Djali i mbretit kërkon t'i shpie kartë mbretit, që ishte *vdekur*» (Mbledhës, 400).

Në ndonjë rast është vetë kuptimi i foljes që s'të lë të dyshosh: «Kur ha ti, *ngrënë* jam unë». (Xoxa, Novela, 54).

Me pjesoret e foljeve kalimtare veprore ky tip i kallëzuesit emëror ndërtohet zakonisht me inversion: «— Hapni dritaret, çuna, hapni të shkretat, se u mbytëm. — *Hapur* janë; xha Sali, . . .» (Abdihoxha, Vjeshtë, 8); «Po ja, *mbledhur* është fshati» (Sako, Buka, 22); «*Mbytur* në djersë ish beu, po mendja i punonte». (Xoxa, Novela, 58); «Pika ishte pothuaj *ngjitur* me murin» [19] (Kadare, Kështjella, 94).

Pjesorja e foljes *shkoj-shkuar* me emra në funksion predikativ (përcaktor kallëzuesor ose kallëzues emëror) dhe me numërorë themelorë ka marrë vlerën e një ndajfoljeje sasie në shkallën krahasore *(më shumë):* I) «kanë qenë, o bijtë e mi, zagarë e *shkuar* zagarëve» (Xoxa, Novela, 18);

16) K. Cipo, *Sintaksa*, f. 42.

17) M. A. Gabinski, *Pojavlenie i utrate pjerviçnogo allbanskogo infinitiva*, Leningrad, 1970, f. 75.

18) M. A. Gabinski, *po aty*, f. 75.

19) Në ndërtimet e modelit të shembullit të fundit *pjesore — parafjala me*, mund të bëhet fjalë edhe për një parafjalë të përbërë (lokucion parafjalor), si në rastin *lidhur me*, sepse vihet re një desemantizim i pjesores dhe shkrirje funksionale e saj me parafjalën.

2) «S'ke ç'i bën, kapedan, dhe kapedanët aso kohe ishin *shkuar* prefektit» (Xoxa, Novela, 10), një burrë *shkuar* pesëdhjetat, *shkuar* dyzetat etj.

Në funksionin e përcaktorit kallëzuesor të kryefjalës ose të kundrinës, pjesorja mund të paraqitet edhe si gjymtyrë e zgjeruar, edhe e pazgjeruar. Pjesorja si gjymtyrë e zgjeruar, zakonisht me një plotës vendi, mënyre, shkaku, ka plotësisht vlerë foljore, ndërsa e pazgjeruar në shumë raste anon edhe nga ndajfolja. Dhe është pikërisht funksioni kallëzuesor që ka lehtësuar kalimin e mjaft pjesoreve në ndajfolje, sepse «Dihet që përcaktori predikativ është një gjymtyrë fjalie e ndërmjetme midis epitetit dhe rrethanorit dhe që, sipas rrethanës, ai mund të pritet nga njëra anë në tjetrën» [20].

Na duket i drejtë pohimi i E. Hysës [21] se rrethi i pjesoreve që përdoren si ndajfolje, po zgjerohet. Kalimi i fjalëve nga një pjesë e ligjëratës në një tjetër, siç dihet, karakterizohet nga ndryshime në përmbajtjen kuptimore, në veçoritë morfologjike dhe në funksionet sintaksore.

Në qoftë se pjesoret pushojnë së treguari një veprim si tipar të një sendi dhe shënojnë tashmë mënyrën e kryerjes së një veprimi, rrjedhimisht përdoren në fjali si plotësa mënyre, kjo tregon se ato kanë kaluar përfundimisht në klasën e ndajfoljeve. Këtë e vërteton edhe pamundësia për t'u këmbyer me pjesoren e adjektivuar dhe aftësia për të formuar shkallë krahasimi. Kështu, sipas nesh, janë adverbializuar plotësisht pjesoret e foljeve *hidhur, prerë, ngjitur, shtruar, hapur, ndenjur, shkoqur, mërguar* e ndonjë tjetër, të cilat në të njejtën kohë përdoren edhe me vlerë foljore tjetër në kontekste të caktuara.

Si ndajfolje: «Kronikani buzëqeshi *hidhur*» (Kadare, Kështjella, 105); «*Më hidhur* të na dhembi largimi jon' i zi». (Poradeci, Lirika, 71); «Po klientët e kishin marrë *shtruar*». (Buxheli, Kali, 140); «Demir efendiu zuri t'i shoshitë punët *më shtruar*» (Abdihoxha, Vjeshtë, 78); «Partia i fliste popullit *hapur*» (H. P. 447); Fol *më hapur* etj. Kur pjesorja ka kaluar në ndajfolje të vendit, ajo mund të përcaktojë edhe një emër: «Në rrugën ngjitur (d.m.th. *pranë* — shënimi ynë) kaluan duke kënduar një grup partizanësh» (Buxheli, Kali, 45).

Në ato raste kur pjesorja predikative ka mundësi të ndërkëmbehet gjithandej me mbiemrin foljor, s'duhet bërë fjalë për adverbializim të saj, siç vëren me të drejtë Sh. Demiraj [22]. Prandaj mjaft nga pjesoret që Enver Hysa i merr si ndajfolje [23] *(pështetur, shtrirë, mbathur, zbathur, veshur, zhveshur, zgjuar)*, nuk janë të tilla.

Procesi i kalimit të pjesoreve në ndajfolje nga përdorimi në funksion predikativ është i gjallë dhe aktiv. Kështu që me kohë edhe pjesore të tjera, si, fjala vjen, *fshehur*, kanë për të kaluar në ndajfolje: «Edhe vetë grizarakja u çudit se si i dha kaq shkoqur mendimet e saj, e kaq *fshehur* ngjarjen që e kishte vënë në brengë» (Xoxa, Lumi, I, 249). Të krahasohet ky përdorim me këtë: Për një kohë të gjatë qëndroi *fshehur (i fshehur)*. Edhe përcaktori predikativ i shprehur me një pjesore për-

---

20) E. A. Référovskaïa — A. K. Vasiliéva, *Essai de grammaire française cours théorique*, 1964, f. 169.

21) E. Hysa, *Ndajfolja në gjuhën e sotme shqipe*, «Studime filologjike», 3, 1970, f. 49.

22) Sh. Demiraj, *Rreth ndajfoljëzimit të disa formave gramatikore dhe të disa togjeve të tipit parafjalë-emër*, «Studime filologjike», I, 1970, f. 140.

23) E. Hysa, *artikull i cituar*, f. 49.

doret shpesh si gjymtyrë e veçuar, zakonisht i zgjeruar: «Para saj, *ulur* mbi një sunduk. qëndronte doktor Hamiti . . .» (Buxheli, Kali, 73); «Shkoi ta presë në bisht të qerres, *mbështetur* e *kapardisur* pas kapistallit të pasmë» (Xoxa, Lumi, 1, 178); «. . . i a tregonin sytë të thellë, *rrethuar* me qenar të zi». (Abdihoxha, Ngjyra, 1, 33).

IV) Pjesorja përdoret gjerësisht edhe në një konstrukt të veçantë si përcaktor predikativ i një emri të prirë nga parafjala *me*, i cili lot rolin e një gjymtyre të dytë të fjalisë [24]: «Mua më zuri gjumi pranë zjarrit, me kokën *mbështetur* te një samar» (Shuteriqi, Gurnacka, 148); «Oficeri akoma qëndronte në hyrje, me elektrikun *ndezur*» (Buxheli, Kali, 231); «U shtrua në skenë, me gjuhën e kuqe *nxjerrë* përjashta. . .» (Andoni, I dërguar, 67).

Faktin që pjesorja në këtë ndërtim përdoret si predikativ, besoj se e vërteton trajta primare *të* e nyjes, me emra të shquar në kallëzoren njëjës e shumës: me xhaketën *të hedhur* krahëve, me duart *të ngritura* përpjetë. Në konstruktet me nyjen sekundare *e* mbiemri prejpjesor duket qartë që ka vlerën e përcaktorit epitet e jo predikativ: me xhaketën *e hedhur* krahëve, me duart *e ngritura* përpjetë.

Me shtrirjen e përdorimit të nyjes së përparme te mbiemrat prejpjesorë në gjuhën e shkruar të ditëve tona hasen paralelisht, madje edhe në një frazë, si trajta me nyje, ashtu edhe ajo e adjektivuar e pjesores, shpeshherë edhe për variacion stilistik, ose edhe në mënyrë të pavetëdijshme [25], sepse, siç vëren edhe Gabinski, midis këtyre dy konstrukteve s'ka dallime semantike [26]: «Llazi, me hostenin të *kapërcyer* nën sqetull e *të shtrirë* përpara si ushtë, ngiste qetë e pamësuar në këto udhë e në këto të përpjeta, ndërsa Vita, kthyer kurriz më kurriz me të vëllanë me sytë *ngulur* në thellësitë e perëndimit, me kokën *mbështetur* në mes të pëllëmbëve, . . . kishte humbur në një botë lotësh» (J. Xoxa, Lumi, 1, 106). M. A. Gabinski ka vënë re se disa togfjalësha pa artikull proklitik prej kohësh janë leksikalizuar [27], domethënë kanë fituar tiparet e një shprehjeje frazeologjike. Si të tilla ai përmend: *me krahë hapur, me gojë hapur, me sy mbyllur, me duar lidhur, me sy hapur / çelur me llërë përveshur, me kokë ulur* etj. Ne mund të shtonim këtu edhe me *turi varur, me buzë varur, me veshët ngritur*. Në të njëjtën kohë ai vëren se edhe në ndërtimet me artikullin *të* hasen raste leksikalizimi si *me zemër të thyer, me zemër të hapur*.

Sipas mendimit tonë procesi i leksikalizimit ka prekur rregullisht konstruktet me emër të pashquar.

Në togjet e leksikalizuara, pjesorja, në origjinë predikative, funksionon bashkë me emrin si një gjymtyrë e vetme e fjalisë, zakonisht plotës mënyre: «E po, ç'më rri *me buzë varur* . . .» (Buxheli, Kali, 182) ose plotës predikativ me folje të tilla si *mbes, lë, gjej, iki:* «Kronikani mbeti *me gojë hapur*» (Kadare, Kështjella, 142); e la *me gojë hapur*, iku *me kokë ulur*. Më rrallë ky ndërtim ka vlerën e epitetit të një emri: «Larushja *me llërë përveshur* . . . rendi nëpër oborr. . . (Sako, Buka, 27).

---

24) Shih edhe S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe* (dispensë), pjesa e parë, 1959, f. 96.

25) Shih M. A. Gabinski, *vepër e cituar*, f. 77.

26) M. A. Gabinski, *po aty*, f. 77.

27) M. A. Gabinski, *vepër e cituar*, f. 75.

Në ndërtimet që po shqyrtojmë, kur vijnë njëra pas tjetrës gjymtyrë të tilla të bashkërenditura, parafjala *me* mund të mos përsëritet: «Më pat marrë gjumi me laps në dorë, dorën *varur* poshtë, mjekrën *mbështetur* në tryezë e ballin *ngjitur* me pllakën e radios... (Andoni, I dërguar, 132).

Konstruktet pa parafjalën *me* hasen rregullisht, kur pjesorja bën pjesë në një gjymtyrë të veçuar e të zgjeruar, e cila qëndron në mes të një fjalie mungesore e të një gjymtyre fjalie: «E ata gjithë punojnë, *ngritur* me bres peçinjtë». (Frashëri, Bagëti, 19); «Dhe pastaj me salltanet, *veshur* armët si një mbret, shkon kaluar në kështjellë...» (Noli, Album, 85); «E shoqja e Lames, bucelën me ujë *ngarkuar*,... po ngjitej në shtëpi». (Sako, Buka, 10); «... ngrihej një ndërtesë më e vogël e lyer përjashta me sherbet të bardhë gëlqereje, qemeret e sipërme *lyer* me bojë kafe të errët...» (Andoni, I dërguar, f. 74); «... e pastaj, duar e kokë *varur*, u ngjitën lart» (Xoxa, Lumi, 1, 169).

Në ndërtimet e këtij tipi me ose pa parafjalën *me* ka disa herë edhe lëkundje drejtshkrimore (shkrimi bashkë dhe me vijë ndarëse), gjë që tregon se ato shpeshherë ndihen si një fjalë e vetme: «... kish dëgjuar me *gojëhapur*» (Buxheli, Kali, 141); «Seç vajton Shën Pjetri hidhur, *lesh-lëshuar*, *duar-lidhur*, tri her'e mohoi pa gdhirë, *faqe-nxirë*» (Noli, Album, 48). Siç është vënë në dukje edhe më parë, nëpërmjet këtij përdorimi kanë lindur mbiemrat e përbërë me gjymtyrë të dytë një mbiemër [28] ose një pjesore [29] të tipit buhuvrihi.

V) Pjesorja së bashku me gjymtyrët që varen prej saj, përdoret rrallë edhe në një ndërtim të ngjashëm me atë absolut, por ndryshon prej tij, sepse ka të njëjtin subjekt me foljen e fjalisë prej nga varet. A. Xhuvani ka vënë në dukje një nga funksionet më të shpeshta të këtij ndërtimi, atë kohor [30], në fjali të tilla: «Zbriturë poshtë qerozi, zu të kërkojë gjurmat e llamijes» (popullore). Në letërsinë artistike konstruktet kohore me pjesore janë po aq të rralla, sa edhe në prozën popullore: «... *gjendur* papritur në buzë të karros,... nëpunësi i kadastrës u vajis nja dy herë sa më një krah më një krah» (Xoxa, Lumi, 1, 79). Të rralla janë po ashtu edhe ndërtimet me vlerë shkakore: «*Mbështjellë* me mushama, ato dukeshin të frikshme...» (Kadare, Kështjella, 24).

Në ndërtimet e këtij tipi pjesorja mund të jetë ekuivalente me përcjelloren dhe tregon në këtë rast një veprim që shoqëron a përcjell një veprim tjetër: «*Mbështetur* mbi maliher, ai u hoq duke çaluar, në drejtim të barakës» (Buxheli, Kali 64).

Mënjanimi i këtyre ndërtimeve në gjuhën e shkruar shpjegohet me shtrirjen e përdorimit të mbiemrit foljor, që ruan kuptimin e pjesores. Kjo shtrirje nga ana e saj duhet shpjeguar me prirjen e vetë gjuhës, dhe jo si ndikim i gjuhëve neolatine, siç mendon Xhuvani [31].

Ndërtimet me mbiemra janë të zakonshme në letërsinë artistike dhe në publicistikë: «*E rrahur* nga greku, nga sërbi e bullgari do gjak të thëthinjë dhe vjen te shqiptari...» (Noli, Album, 31); «*Të vënë* midis dy

---

28) E. Çabej, *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe*, BUShT, SShSh, 3, 1963, f. 83.

29) M. A. Gabinski, *vepër e cituar*, f. 77-78.

30) A. Xhuvani, *Pjesorja në shqipet*, «Studime gjuhësore», f. 206.

31) A. Xhuvani, *po aty*, f. 206.

zjarresh, shqiptarët u muntnë...» (Noli, Histori, f. 20); «*E ulur* në buzë të sofrës, përgjoi me orë të tëra zhurmat më të vogla» (Abdihoxha, Vjeshtë, 71).

VI) Nëpër dialogje pjesorja përdoret edhe me vlerën e një fjalie thirrmore ose pyetëse. Në fakt fjalia është e paplotë dhe pjesorja përfaqëson kohën e përbërë të foljes së përmendur më lart, për veprimin e së cilës bashkëbiseduesi habitet ose pyet i habitur:

«—I kanë gënjyer njerëzit e këqinj — *Gënjyer!* — përsëriti nxënësi, duke tundur kokën në dilemë» (Abdihoxha, Vjeshtë, 100).

«Pse je tretur kështu, Linditë? Ke qenë gjë e sëmurë? — *Tretur?!* — Lindita mbështolli fustanin ndën gjunjë, se frynte erë. (Buxheli, Kali, 284).

VII) Pas foljeve modale *duhet* (lypset) vihet shpesh pjesorja, e cila nga pikëpamja e funksionit është e barasvlershme me paskajoren [32] dhe mund të zëvendësohet prej saj (fjala është për paskajoren e tipit *me ba*). Por siç është vënë re me të drejtë, ajo s'ka vlerën e paskajores, sepse në foljet kalimtare ka kuptim pësor, ashtu si pjesorja [33]. (Duhet *bërë* kjo punë — duhet *me u ba* kjo punë, duhet *të bëhet* kjo punë).

Sinonimik me këtë është edhe konstrukti *do bërë*, që takohet më rrallë. Në këtë konstrukt folja *dua* (do) thuajse është shndërruar në një pjesëzë të pandryshueshme, po të lëmë mënjanë trajtën e shumësit (*duan* pasur parasysh edhe këto gjëra), që është edhe më e rrallë.

Shkurtimet

Abdihoxha, Ngjyra	— A. Abdihoxha, Tri ngjyra të kohës, 1, 1965.
Abdihoxha, Vjeshtë	— A. Abdihoxha, Një vjeshtë me stuhi, 1959.
Andoni, I dërguar	— S. Andoni, I dërguar nga klasa, 1970.
Arapi, Dhjetor	— F. Arapi, Dhjetor i shqetësuar, 1970.
Asllan, V.p.	— A. Asllani, Vidi, vidi, pëllumbeshë, 1960.
Buxheli, Kali	— Q. Buxheli, Kali i mbretit dhe kalorës të rinj, 1960.
Frashëri, Bagëti	— N. Frashëri, Bagëti e bujqësia, 1955.
Frashëri, Lulet	— N. Frashëri, Lulet e verësë, 1956.
H.P.	— Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë, 1969.
Kadare, Dasma	— I. Kadare, Dasma, 1968.
Kadare, Kështjella	— I. Kadare, Kështjella, 1970.
Mbledhës	— Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar, I, 1961.
Noli, Album	— Fan S. Noli, Album, 1958.
Noli, Histori	— Fan S. Noli, Histori e Skënderbeut, 1957.
Poradeci, Lirika	— L. Poradeci, Lirika (pa vit botimi).

32) Shih edhe M. Domi, *Morfologjia historike e shqipes* (dispensë), 1961, f. 67, M. A. Gabinski, *vepër e cituar*, f. 23.

34) Sh. Demiraj, *Rreth disa problemeve të paskajores në gjuhën shqipe*, «Studime filologjike», 1, 1969, f. 88-89. Një argumentim të plotë karakterit participor të elementit **bërë** në konstruktin duhet *bërë* i ka bërë M. A. Gabinski, në veprën e cituar f. 24 e vijim.

Sako, Buka — Z. Sako, Buka jonë e përbashkët, 1965.
Shuteriqi, Gurnecka — Dh. S. Shuteriqi, Gurnecka, 1957.
Xoxa, Juga — J. Xoxa, Juga e bardhë, 1, 1971.
Xoxa, Lumi — J. Xoxa, Lumi i vdekur, 1, 2; 1965.
Xoxa, Novela — J. Xoxa, Novela, 1958.

R é s u m é

LE PARTICIPE EN ALBANAIS

L'auteur fait, dans cet article, une tentative d'analyse plus approfondie des catégories et des fonctions du participe. Au début est esquissé un tableau succinct des traitements faits jusqu'à présent de cette catégorie dans les principales grammaires de la langue albanaise et dans des études de spécialité.

A l'avis de l'auteur, il n'existe en albanais qu'une seule forme du participe qui n'a ni de diathèse, ni de temps, ni de catégorie morphologique. Les formes à article, qui gardent souvent le sens et la relation verbale, sont traitées comme adjectifs.

Une argumentation plus détaillée de cette question a été donnée par l'auteur dans un autre article sur les parties du discours en albanais, paru dans ce même bulletin. Cette fois, l'auteur raffermit l'opinion connue que le participe, en tant que partie du discours en albanais contemporain, ne connaît qu'un usage circonscrit. Cela est expliqué par la tendance ancienne de l'albanais à substituer les constructions participiales par des constructions à participe adjectivé. Tout de même, dans les productions de plusieurs auteurs, surtout de ceux qui restent plus proches de la langue populaire, est observé un usage relativement vaste des constructions participiales.

La deuxième partie porte sur les fonctions syntaxiques du participe. L'analyse repose sur du matériel glané dans les productions de plusieurs auteurs, depuis la Renaissance à nos jours. On y distingue les fonctions suivantes du participe: comme épithète, déterminatif isolé, déterminatif prédicatif d'un autre membre de la phrase précédé par le préfixe *me*.

Est soumis à analyse, dans cet article, aussi une construction similaire à celle absolue, mais qui varie de celle-ci, du fait qu'elle a le même substantif du verbe de la phrase dont elle dépend.

Pour la catégorisation grammaticale de la forme identique au participe, mais ayant une fonction similaire à celle de l'infinitif après les verbes modaux *duhet* (lypset) et *do*, l'auteur souscrit aux études les plus récentes sur cette question: il admet qu'on y a affaire à un participe, non point à un infinitif.